

PROCESVERBAL

MBLEDHJA E KB, DATË 15 SHTATOR 2023, ORA 16:00

Pas plotësimit të kuorunit të nevojshëm të numrit të këshilltarëve në sallë (49 anëtarë), Kryetarja e Këshillit Bashkiak, znj. Romina Kuko deklaroi të hapur mbledhjen e Këshillit Bashkiak, duke lexuar rendin e ditës.

1. Projektvendim "Për miratimin dorëheqjes së mandatit të këshilltares së Këshillit Bashkiak, znj. Katerina Marku".
2. Projektvendim "Për miratimin e familjeve aplikuese që përfitojnë nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 përqind, nga fondi i kushtëzuar dhe nga buxheti i Bashkisë Tiranë, për periudhën 1- 30 qershor 2023".
3. Projektvendim "Për miratimin e familjeve aplikuese që përfitojnë nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 përqind, nga fondi i kushtëzuar dhe nga buxheti i Bashkisë Tiranë, për periudhën 1- 31 korrik 2023".
4. Projektvendim "Për emërtimin e një sheshi në territorin e Bashkisë Tiranë".
5. Projektvendim "Për vendosjen e skulpturës "Rrënjët e Kujtimit" në sheshin "Bukuresht" njësi administrative nr.10".
6. Projektvendim "Për emërtimin e disa rrugëve në territorin e Bashkisë së Tiranës".
7. Projektvendim "Për miratimin e bonusit të qirasë të individëve/familjeve, pasuritë e të cilëve preken nga zbatimi i projektit të segmentit rrugor "Unaza e madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja- Bulevardi i ri, Shkozë".
8. Projektvendim "Për miratimin e pagesës së qirasë sipas vlerës së tregut të lire, të individëve/familjeve, pasuritë e të cilëve preken nga shpronësimi për interes public, në funksion të procesit të rindërtimit, me qëllim realizimin e projekteve "Për zonat e reja në zhvillim, në Njësitë Administrative nr.4 dhe 8, zona "5 Maji".
9. Projektvendim "Për disa ndryshime në vendimin nr.2, datë 30.03.2009, të Këshillit Bashkiak, "Mbi miratimin e Rregullores, për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi në qytetin e Tiranës, i ndryshuar".
10. "Për disa ndryshime në vendimin nr.101, datë 19.10.2022, të Këshillit Bashkiak "Për kompensimin e biletës së pajtimit mujor të përgjithshëm (abonesë së studentit), për studentët e pajisur me kartë student për të gjitha linjat, në transportin qytetës në Bashkinë e Tiranës".
11. Projektvendim "Për disa ndryshime në vendimin nr.142, datë 23.12.2022, të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe

Qendrës Shqiptare të Trashëgimisë për themelimin e përbashkët të organizatës jofitimprurëse qendrës "Trashëgimia për të gjithë – Garda" dhe aktiviteteve të themelimit të kësaj organizate jofitimprurëse".

12. Projektvendim "Për miratimin e projektit "Sipërmarrja ime për shkollën", hartuar sipas udhëzuesit operacional për zbatimin e tij".

13. Projektvendim "Për disa ndryshime në vendimin nr. 126, datë 23.12.2022, të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2023, të ndryshuar".

SHTESË

14. Projektvendim "Për dhënien e ndihmës financiare, nga Bashkia e Tiranës për Komunën e Preshevës dhe Bashkinë Kharkiv".

15. Projektvendim "Për prishjen e detyruar të ndërtesës private, pallati nr.45, rruga "Luzi", Njësia Administrative Kashar, si rezultat i dëmtimit nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019".

Hidhet në votim rendi i ditës me 31 vota pro. 18 anëtarë të opozitës nuk marrin pjesë në votim.

Pas leximit të rendit të ditës kryetarja e Këshillit Bashkiak, i jep fjalën kryetarit të Bashkisë, z.Erion Veliqaj, për prezantimin e projektakteve.

Nënkryetari i Këshillit Bashkiak, z.Dorjan Teliti kërkon fjalën për procedurë. Kryetarja e Këshillit Bashkiak i jep fjalën kryetarit të Bashkisë.

"Hapëm shkollën tek Medreseja. Këta që s' bënë asnjë shkollë dhe shkollën e Medresesë e kthyen zyra për Ujësjellësin. Ne e rikthyem shkollë dhe u hap shkolla Lekë Gjikhuri ndërkohë që jemi në ditët e fundit

Janë disa shkolla që ne i kemi ndarë në dy lote. Një lot janë shkollat që bën Bashkia e Tiranës. Aty kemi ecur pak më shpejt dhe në fakt ka edhe më pak burokraci sepse është vetëm një institucion ndërkohë që është një paketë tjetër shkollash që menaxhohet nga BE , prej fondeve të BE. Siç thotë ajo shprehja : Kalit të duruar nuk i shihen dhëmbët", kështu që ata kanë procedurat e tyre. Edhe me Brukselin, edhe me Neë York pasi është edhe PNUD dhe BE dhe Komisioni. Në këtë sens ata kanë një procedurë pak më të gjatë. I kemi zgjidhur disa ngërçe ku kanë qenë ndërtime pa leje, ndaj them duhet folur për shkollat se ata që i legalizuar e lejuan ndërtimet brenda në shkollë, sigurisht që nuk duan t'i dëgjojnë këto muhabetë.

Për të gjithë prindërit që kanë pyetur për shkollën "Emin Duraku", qytetarët që kanë pasur shqetësim shkollën "Emin Duraku", kemi pasur një situatë të mbartur nga vitet e "lavdishme" '90, ku është legalizuar dhe është bërë ndërtimi pa leje ngjitur me murin e shkollës. Muri i shkollës, i palestrës ka qenë i njëjti mur me shtëpinë ngjitur, kështu që edhe procedurat për prishjen, që edhe asaj familje që i është njohur e drejta e legalizimit dhe hipotekës të mos e

humbasë ka marrë kohën e nevojshme. Kemi gjetur një mirëkuptim, kemi gjetur edhe një teknikë se si mund të prishet ai mur, edhe familja ta gëzojë pronën. E bëri si e bëri në ato vite por edhe shkolla të ndërtohet nga e para. Më në fund, lajmi i mirë për prindërit e shkollës "Emin Duraku", është zhbllokuar edhe ajo situatë.

Kemi pasur disa pyetje edhe nga kolegët e opozitës për shkollën "Partizani". Këto janë rregullat e shtetit të përbashkët që kemi vënë të gjithë bashkë. Ka pasur ankimime. Procedura thotë që ti duhet të presësh derisa të mbarojë. Jemi në javën e fundit të procedurës për të blerë të gjithë ...dërrasat dhe gjithë materialet didaktike, kështu që për të gjithë këshilltarët që përfaqësojnë zonën e njësisë 8, tek "Partizani", kam përshtypjen javën tjetër skadon afati i ankimimeve dhe do të vijojmë edhe aty.

E njëjta me "Xhezmi Dellin", "Asim Vokshin" dhe me "Bedri Llagamin". Këta që acarohen shumë, Bedri Llagami duhet të futeshe njëherë në lokal brenda. Në lokal ishte legalizuar, ndërtuar pa leje në oborr të shkollës, hipotekuar, legalizuar. Duhet të hyje fillimisht në lokal, pastaj të dilje nga lokali për të shkuar në shkollë. Sigurisht, tani me ligjet që kemi ti nuk e prish dot pavarësisht se këta e lejuan, por nuk e prish.. Do ë bësh me rregulla. Edhe aty bëjmë gjithë procedurën, u prish lokali i shkollës së fëmijëve dhe tani fëmijët mund të shkojnë në shkollë, pa u futur nga lokali. Për të gjithë ata që kanë bërë pyetje në lidhje me hapjen e vitit të ri shkollor, kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme.

Kam qenë në kontakt, jo vetëm me organet e drejtësisë por edhe me menaxhimin e ri shtetëror të landfillit të Tiranës, fakti që Bashkia e Tiranës ...

Brahimllari: që nuk ekziston....

Veliaj: Fakti që ...Po ekziston me vendim gjykatë. Dëgjo, kështu që, ja ta tregoj unë faturën! Kjo këtu që shihni të gjithë është Bashkia e Kavajës. Bashkia e Kavajës në 22 gusht e ka paguar inceneratorin 122 milionë lekë. Bashkia e Kavajës që e drejtojnë këta. Pra, këta thonë: Në Kavajë do ta bëjmë pastrimin, këta janë ca hipokritë që flasin gjithë ditën dhe kanë vajtur të parët të paguajnë lekët, sepse Kavajën nuk duan ta lënë pis por në Tiranë duan ta lënë pis, sepse e kuptojnë që pis e lanë. U detyruam që pastruam. Ja ku e kenë Bashkinë e Kavajës. Këta janë ca hipokritë dhe është turp që çuna të rinj i japin fytyrën Saliut, që goca të reja i japin fytyrën Ilir Metës, sepse në të vetmen bashki të vogël që drejtojnë, në 22 gusht, në mes të pushimeve vajtën e i paguan xhixhat. Këta e kuptojnë që nuk ka gjë pa lekë. Nuk ka gjë pa lekë dhe vajtën në mes të verës, paguan 122 milionë lekë, se ata e kuptojnë që nuk ka drekë falas. Edhe kur e menaxhon shteti, ka kosto; edhe kur

Brahimllari: E ke firmosur në kundërshtim me ligjin

Veliaj: Për sa kohë që këta e paguan Kavajën si çëço, se nuk ua mban të rrinë një ditë me vonesë. Bashkia e Tiranës është sot më e pastër se zhuli që latë ju, është pa atë renë veshulllore që prodhuat ju, është pa ata njerëzit që turrëshin aty, për të marrë plehra. Është sot qyteti më i pastër

në Ballkan dhe hipokrizia juaj, që duhet t'ju vijë turp. Vajtët latë pushimet dhe paguat inceneratorin e landfillin për Kavajën që e drejtoni vetë dhe ndërkohë thoni: Bëni si them unë por jo si bëj unë! Ne do themi si është ligji dhe Tirana do vaz

Në finale, kam një falenderim për të gjithë kolegët që dje u përfshinë në një betejë të jashtëzakonshme, në luftën kundër zjarrit. Një zjarr i hapur aksidentalisht dhe sic e pamë sot nga Policia e Shtetit dhe zjarrëfikësit, kam përshtypjen që ka dalë deklarata.

(I drejtohet opozitës) E di që edhe për zjarrin ju djeg se pas Gërdecit e keni shumë të vështirë të flisni për zjarrëfikësat. E keni shumë të vështirë. Pasi hodhët në erë 26 njerëz e keni shumë të vështirë.

Kur bie muhabeti te sigurimi shtetit dhe ... del Gërdeci dhe del fuksi dhe të shqetësohet por për ne që jemi njerëz normal, që jetojmë me njerëz normal dhe që bëjmë jetë normale dua të falenderoj gjithë zjarrëfikësit dhe ata që erdhën të na ndihmojnë nga Vora dhe nga Kamza. Kanë bërë një punë të lavdërushme dhe të jashtëzakonshme dje. Dua të falenderoj të gjithë ata që u morën me hetimin në ditën e sotme. Ashtu sic kuptuam ishte një kondicioner dhe mënyra se si ishte lidhur gabimisht dhe se si ishte futur në atë fasadë. Megjithatë njoftimin zyrtar do ta bëjnë zjarrëfikësit dhe Policia e Tiranës por, për të gjitha ata djem dhe për ata që u shtruan në spital unë kam vetëm mirënjohje dhe vetëm respekt se vetëm njerëzit e punës e cojnë Tiranën përpara.

(Largohet nga mbledhja kryetari i Bashkisë dhe në mbledhja është prezent nënkryetari i bashkisë, z.Andi Seferi)

Pas përfundimit të fjalës së kryetarit të Bashkisë, mbledhja ka vijuar me shqyrtimin e rendit të ditës. Kryetarja e Këshillit, znj.Romina Kuko, i ka dhënë fjalën kryetarit të grupit demokrat, z.Illir Alimehmeti, për procedure, lidhur me kërkesat e dërguara me email.

Ai ka kërkuar që kërkesat të trajtohen në vijim të rendit të ditës, pasi janë informacione që janë kërkuar nga opozita, por nuk u janë vënë në dispozicion, pavarësisht se janë kërkuar në mënyrë të përsëritur. Z.Alimehmeti, i jep fjalën e tij këshilltarit z.Dorjan Teliti.

Ky i fundit, ka rikujtuar se lidhur me projektvendimet në rendin e ditës që kanë të bëjnë me tjetërsim prone, si ligji ashtu edhe rregullorja e KB thotë se duhen realizuar dëgjesa dhe konsultime publike, të cilat sipas tij nuk janë kryer. Ndërkohë që neni 44 i Rregullores thotë që nëse nuk është kryer kjo lloj procedure, atëherë Këshilli ka të drejtë të shtyjë vendimmarrjen.

Kryetarja e Këshillit është shprehur se përderisa nënkryetari z.Teliti nuk po flet për procedurë, fjala i takon kryetarit të grupit të "Shtëpia e Lirisë", z.Ëndrit Braimllari.

Përfaqësuesi i këtij grupi, u shpreh se lidhur me pikën 13 të rendit të ditës, nuk mund të futet për shqyrtim pa u diskutuar më parë dhe konsultuar. Kryetarja e Këshillit Bashkiak, znj.Romina

Kuko, u shpreh se në fillim të diskutimeve, anëtarët e Këshillit mund ta marrin fjalën vetëm për procedurë, ndërkohë që në vijim, fjala do t'u jepet të gjithëve për pikat e rendit të ditës.

Kryetarja e grupit të PD, znj.Enriketa Pandelejmoni është shprehur në fjalën e vet se edhe në email ka kërkuar që në rendin e ditës të shtohet edhe një pikë "Të tjera", e cila duhet të bëhet një procedurë e zakonshme për çdo mbledhje, për të ngritur çështje të ndryshme, nga ana e këshilltarëve.

Znj.Kuko i ka kujtuar parafolëses afatet për dorëzimin e kërkesave të tilla, në mënyrë që të futen në rendin e ditës.

Në fjalën e tij, këshilltari z.Tedi Blushi, ka kërkuar përgjigje për kërkesën e bërë për pjesëmarrjen në mbledhje të përfaqësuesit të shoqatës së Para Tetraplegjikëve, z.Ali Plaka, në shërbim të transparencës dhe përejelljes së zërit të qytarëve, për shqetësimin e ngritur prej tij lidhur me ndërtesën në përdorim nga kësaj shoqate.

Në vijim, për shkelje të etikës ndaj këshilltarëve të tjerë, z.Blushi i është hequr e drejta e fjalës dhe kryetarja e Këshillit i ka kthyer përgjigje, duke cituar një paragraf të relacionit të pikës 13 të rendit të ditës.

"Në zbatim të Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr.19247/2, datë 27.6.2023, për "Përmbushjen e detyrimeve që lindin nga titulli ekzekutiv, vendimin nr. 425, datë 28.02.2023, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në favor të kreditorit "Shoqëria Humanitare e Invalidëve Paraplegjik dhe Tetraplegjik të Shqipërisë", propozohet përfshirja në PBA 2023 - 2025, të kostove për Studim Projektimin e objekteve: Ndërtimi i rrugës që lidh pronën nr. 99 "Reparti Ushtarark nr.5011/45", Surrel me rrugën nacionale, me gjatësi rreth 550 ml, e cila ka nevojë për ndërtimin e plotë të shtresave asfaltike, si dhe trotuare, ndricim, etj. Rikonstruksioni i godinave dhe hapësirave në pronën nr. 99, Reparti Ushtarak 5011/45, Surrel, e cila parashikon rikonstruksionin e 3 objekteve me sipërfaqe totale ndërtimi rreth 600 m2, si dhe hapësirave të vëna në dispozicion, brenda rrethimit i cili pritet të realizohet brenda këtij viti".

Znj.Kuko tha se pas miratimit të vendimit, përfaqësuesit e shoqatës do të ftohen në diskutimet e komisioneve dhe nëse gjykohet e nevojshme edhe në mbledhjen e Këshillit Bashkiak.

Përfaqësuesja e opozitës, znj.Silva Caka, ka shprehur shqetësim lidhur me kohën e shpërndarjes së njoftimit të mbledhjes si dhe me materialet shtesë të futura në rendin e ditës, për të cilat, këshilltarët nuk kanë kohë të mjaftueshme për t'u njohur. Gjithashtu, ajo u shpreh se në mbledhjet e komisioneve, bashkia u përfaqësua për relatimin e materialeve, nga niveli më i ulët hierarkik i administratës. Ajo tha se bashkohet me kërkesën e kryetarit të komisioneve të Çështjeve Ligjore, që në komisione të jenë prezent drejtorët e përgjithshëm.

Kreu i grupit të mazhorancës, z.Eridian Salianji ka propozuar që në rastet kur merret fjala për procedurë, kjo të bëhet vetëm nga krerët e grupeve, sepse nuk mund të flasim gjithë këshilltarët për procedurë.

Në vijim të mbledhjes, kryetarja e Këshillit i ka dhënë fjalën kryetarëve të komisioneve, që kanë

shqyrtuar projektaktet e propozuara, duke filluar nga kreu i komisionit të Çështjeve Ligjore dhe Drejtësisë Sociale.

z.Plarent Ndreca ka lexuar raportin e këtij komisioni, duke nënvizuar problematikat e vërejtura gjatë shqyrtimit të projektvendimeve si dhe mendimin e anëtarëve për secilën prej pikave të rendit të ditës.

Ai ka theksuar se në mbledhjet e komisioneve, duhet të jetë e detyrueshme pjesëmarrja e drejtorëve të përgjithshëm për relatimin e akteve.

z.Dorjan Teliti i është referuar Rregullores (neni 45), duke thënë se kryetarët e komisioneve nuk duhet të paraqiten me një raport total të projektvendimeve, në mbledhjen e Këshillit, por duhet të merren pikat një nga një dhe t'i lihet kohë edhe anëtarëve të tjerë të komisionit të shprehën.

Z.Salianji u shpreh se një procedurë e tillë është ndjekur në çdo mbledhje këshilli për të sqaruar mendimin e çdo komisioni. Nëse këshilltarët kanë vërejtje, propozime apo çështje të tjera, ata mund të diskutojnë.

Në zbatim të Rregullores, znj.Kuko i është drejtuar anëtarëve nëse kanë pyetje lidhur me raportin e komisionit të Çështjeve Ligjore.

Z.Genc Gjokutaj u shpreh se që nga mbledhja e kaluar ka ngritur një pyetje lidhur me pagesat për mbledhjen e mbetjeve të integruara, por i është kthyer përgjigjia se është jashtë teme. Ndërkohë që në këtë mbledhje, ka vend për të diskutuar për këtë, përderisa është përfshirë në pikën 13 të rendit të ditës.

Kryetarja e Këshillit u shpreh se për të vijuar me procedurën duhet të vijohet me raportet e komisioneve të përhershme që kanë shqyrtuar pikat e rendit të ditës dhe më pas të vazhdohet me projektaktet.

Nënkryetari i komisionit të Financave dhe Buxhetit, z.Jonathan Pano lexon raportin e komisionit.

Më tej, lexon raportin kreu i komisionit të Planifikimit Urban dhe Strehimit Social, z.Hantin Bonati.

Znj.Joleza Koka, si sekretare e komisionit të Kulturës, ka lexuar raportin e këtij komisioni.

Këshilltarja, znj.Mirela Ruko ka kërkuar sqarim lidhur me pikën 10 të rendit të ditës, nëse bëhet fjalë për një numër të kufizuar abonesh, apo secili student që posedon një kartë mund të pajiset me abone.

Në emër të komisionit të Edukimit dhe Infrastrukturës Arsimore, raportin e ka mbajtur kryetarja, znj.Silva Caka, e cila tha se pika 11 e rendit të ditës është miratuar me votat e gjithë anëtarëve të komisionit. Ajo ka theksuar se janë bërë disa pyetje dhe sugjerime gjatë mbledhjes, duke nisur nga kërkesa për të patur një përfaqësi nga Këshilli Bashkiak në bordin e përzgjedhjes së projekteve fitues.

Anëtarja e komisionit të Kulturës, znj. Albana Kepi, lidhur me pikën 11 të rendit të ditës, ka kërkuar vënien në dispozicion të dokumentacionit të paraqitur nga qendra, përfshirë emrat e bordit dhe dokumente financiare që vërtetojnë fondin, si dhe kontratën e firmosur nga kryetari i Bashkisë.

Kryetarja e Këshillit Bashkiak sqaroi se për këtë koment duhet të kërkohet një shkresë zyrtare drejtuar Bashkisë dhe në zbatim të afateve të përcaktuara nga ligji, duhet të pritët një përgjigje nga institucioni.

Këshilltarja znj. Eriona Bixha, komentoi për pikën 10 të rendit të ditës, duke u shprehur se nuk përfshihen gjithë linjat e autobusëve për Tiranën. Ajo i drejtoi pyetje përfaqësuesit të nënkryetarit të Bashkisë se si është menduar, përderisa periudha kohore që përfshin këtë kompensim nuk është i gjithë viti shkollor.

Znj. Floida Kërpaçi ka pyetur nëse është parashikuar ndonjë përfitim tjetër për studentët që zotërojnë kartë. Ky projekt i propozuar a shmang radhët dhe a është mjaftueshëm për çdo të ri që studion në Tiranë, ka qenë pyetja tjetër.

Ajo ka kërkuar gjithashtu një inventar të gjendjes së shkollave në kryeqytet, ku të jetë përcaktuar qartë numri i kompjuterave dhe tabletave që kanë në përdorim. Një tjetër pyetje e saj ka qenë për informacion dhe transparencë lidhur me pagesat që po bëhen për incerehatorët.

Në emër të grupit të PD, pyetjet janë drejtuar nga znj. Enriketa Papa (Pandelejmoni). Ajo ka kërkuar informacion lidhur me një prej emërtimeve të propozuar për rrugë, kontributin e dhënë prej tij dhe të tjera sqarime.

Ajo ka kërkuar gjithashtu sqarime dhe dokumentacione shtesë lidhur me pikën 11 të rendit të ditës, për kontratën që po lidhet. Ndërkohë ka kërkuar gjithashtu edhe informacion për pagesat e bëra për menaxhimin e mbetjeve të integruara.

Këshilltari z. Gentjan Muça u shpreh se pavarësisht se Këshilli po miraton një fond të dytë në buxhet për shpërblimin e rezultareve të sportistëve, nuk është mbledhur ende komisioni i Sportit.

Këshilltari z. Endrit Shabani ka drejtuar pyetje nëse është menduar të vendoset një kasë pagese për parkingjet, për të shmangur problemet që mund të ketë pagesa për parkim përmes shërbimit të kompanive celulare.

Këshilltari z. Dorjan Teliti ka kërkuar informacion lidhur me situatën e shpronësimeve në Njësinë Administrative nr.4 dhe 8 dhe zona "5 maji".

Ai ka kërkuar gjithashtu sqarime lidhur me pikën 9, pse filtri i vendosur për uljen e ndotjes (afati kohor 2-3 vjet nga koha e regjistrimit) nuk zbatohet njësoj si për personat fizikë ashtu edhe për ata juridikë.

Lidhur me pikën 11, z. Teliti ka kërkuar informacion lidhur me negociimin e bërë nga bashkia Tiranë për lidhjen e kësaj marrëveshjeje, si dhe emrat e palës me të cilët është bërë ky

memorandum. Ai u shpreh se opozita është pro dhënies së muzeve, por duhet të ketë transparencë lidhur me këtë projektakt.

Z.Teliti tha se për një objekt aktualisht nën sekuestro po jepet një shumë e madhe parash, fond i cili mund të përdorej për ndërtimin e shkollave dhe çerdheve në kryeqytet.

Për një prej projektvendimeve shtesë në rendin e ditës, përfaqësuesi i grupit demokrat tha se duke qenë se bëhet fjalë për tjetërsim prone, ky projektvendim duhet të kishte më tepër kohë në dispozicion për shqyrtim dhe gjithë fazat e tjera të parashikuara nga ligji për vendimmarrjen mbi akte të tilla.

Këshilltarja znj.Iris Beleraj kërkoi të dijë nëse është marrë parasysh sugjerimi i bërë nga komisioni i Financave për ngritjen e një sistemi elektronik për njohjen e kartave të studentëve si abone udhëtimi.

Ajo theksoi se është lënë gjithashtu një porosi për të marrë mendimin e ekspertëve pse afati kohor për mjetet elektrike është vendosur 2-3 vjet, për licencim, dhe pse specifiki ky afat kohor dhe jo 5 vjet.

Në emër të grupit demokrat, z.Hir Alimehmeti ka kërkuar informacion lidhur me pagesat që po bëhen për mbledhjen e mbetjeve të integruara, duke kërkuar transparencë për secilin prej zërave të kontratës.

Për pikën 11 të rendit të ditës, ai kërkoi të dijë nëse do të jepet në dispozicion e gjithë prona apo vetëm godina. Si dhe lidhur me procedurën e përzgjedhjes së qendrës që do të zbatojë këtë projekt.

Në përgjigje të pyetjeve të mësipërme të drejtuara nga anëtarët e Këshillit Bashkiak, ka marrë fjalën nënkryetari i Bashkisë, z.Andi Seferi.

Në përfundim të fjalës së përfaqësuesit të Bashkisë, kryetarja e Këshillit ka sugjeruar që fjala të shkojë për kryetarët e grupeve lidhur me projektaktet dhe më pas të vijohet me votimin. Sepse këshilltarët që kanë bërë pyetje kanë konsumuar kohën e diskutimeve.

Znj.Kuko ka lajmëruar këshilltarët që kërkojnë fjalën për diskutim, se kanë dy minuta kohë secili për të mbajtur qëndrimin e tyre lidhur me projektaktet e rendit të ditës.

Fjalën e ka marrë përfaqësuesja e PD, znj.Enriketa Papa. (2 min)

Këshilltarja znj.Ilda Zhutali, në fjalën e saj, ka vënë theksin në ndryshimet e shpeshta buxhetore që propozon bashkia Tiranë, përfshirë edhe pagesat për menaxhimin e mbetjeve të integruara për të cilën nuk është bërë transparencë dhe të cilat duhet të ishin parashikuar në buxhet përderisa janë detyrime të një kontrate.

Fjalën e ka marrë këshilltarja znj.Iris Bejleri (2 min).

Për shkak të kundërshtive nga disa anëtarë të Këshillit lidhur me kohën e diskutimit, znj.Kuko ka hedhur në votim propozimin që secili diskutim të mos zgjasë më shumë se 2 minuta.

Hidhet në votim. Miratohet me shumicë votash.

Pas këshilltares znj.Iris Beleraj, fjalën e merr këshilltari z.Endrit Shabani.

Diskuton këshilltari z.Gene Gjokutaj (2 min)

Në përgjigje të shqetësimit të ngritur prej tij, lidhur me pagesën ndaj një objekti në sekuestro, këshilltari z.Plarent Ndreca u shpreh se pagesa shkon te një autoritet shtetëror për një shërbim në interes të qytetarëve.

Këshilltarja znj.Albana Kepi ka diskutuar kryesisht lidhur me pikën 11 të rendit të ditës, duke këmbëngulur në kërkesën e saj për transparencë mbi këtë projektakt, për të bërë publik marrëveshjen dhe emrat që përfaqësojnë qendrën.

Këshilltari z.Dorjan Teliti ka shprehur qëndrimin e tij kundër ndryshimeve të shpeshta buxhetore. Ai përmbloodhi qëndrimin e opozitës edhe për pikën 11 të rendit të ditës, për shkak të territ informativ lidhur me këtë projektakt.

Në vijim të diskutimeve, fjalën e ka marrë këshilltari z.Luan Bregasi dhe më pas këshilltarja znj.Joleza Koka, e cila ka kërkuar mbështetjen e gjithë anëtarëve të Këshillit për dhënien e ndihmës financiare në rikonstruksionin e dy shkollave, në Preshevë dhe në Kharkiv të Ukrainës.

Kryetarja e këshillit, znj.Romina Kuko i ka dhënë fjalën kryetarëve të grupeve, duke filluar nga z.Illir Alimehmeti, i cili bëri të ditur qëndrimin e grupit të tij për secilën nga pikat e rendit të ditës.

Pas tij, fjalën e ka marrë kreu i grupit të "Shtëpia e Lirisë", z.Endrit Braimllari, i cili gjithashtu ka deklaruar qëndrimin e grupit të tij ndaj projektakteve të paraqitura nga Bashkia Tiranë.

Më tej, ka diskutuar kreu i grupit të Partisë Socialdemokrate, z.Krenar Canollari dhe më pas kryetarja e grupit të PD, znj.Enriketa Papa. Ajo ka sugjeruar që këshilltarëve t'u lihet më tepër kohë në dispozicion për shqyrtimin e akteve dhe ky afat kohor të jetë të paktën 5 ditë pune.

Këshilltari z.Endrit Shabani ka deklaruar qëndrimin e tij ndaj projektakteve të rendit të ditës, në emër të grupit që përfaqëson në Këshillin Bashkiak të Tiranës.

Në emër të grupit të Partisë Socialiste, fjalën e ka marrë z.Eridian Salianji, i cili gjithashtu ka bërë të ditur qëndrimin e këtij grupi ndaj akteve të propozuara në këtë mbledhje.

1. Projektvendim "Për miratimin dorëheqjes së mandatit të këshilltares së Këshillit Bashkiak, znj. Katerina Marku".

Miratohet me shumicën e votave të këshilltarëve të pranishëm.

2. Projektvendim "Për miratimin e familjeve aplikuese që përfitojnë nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 përqind, nga fondi i kushtëzuar dhe nga buxheti i Bashkisë Tiranë, për periudhën 1- 30 qershor 2023".

Miratohet me shumicën e votave të këshilltarëve të pranishëm.

3. Projektvendim "Për miratin, familjeve aplikuese që përfitojnë nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 mijë, nga fondi i kushtëzuar dhe nga buxheti i Bashkisë Tiranë, për periudhën 1- 31 korri 2023".

Miratohet me shumicën e votave të këshilltarëve të pranishëm.

4. Projektvendim "Për emërtimin e një sheshi në territorin e Bashkisë Tiranë".

Miratohet me shumicën e votave të këshilltarëve të pranishëm.

5. Projektvendim "Për vendosjen e skulpturës "Rrënjët e Kujtimit" në sheshin "Bukuresht" njësi administrative nr.10".

Miratohet me shumicën e votave të këshilltarëve të pranishëm.

6. Projektvendim "Për emërtimin e disa rrugëve në territorin e Bashkisë së Tiranës".

Miratohet me shumicën e votave të këshilltarëve të pranishëm.

7. Projektvendim "Për miratimin e bonusit të qirasë të individëve/familjeve, pasuritë e të cilëve preken nga zbatimi i projektit të segmentit rrugor "Unaza e madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja- Bulevardi i ri, Shkozë".

Miratohet me shumicën e votave të këshilltarëve të pranishëm.

8. Projektvendim "Për miratimin e pagesës së qirasë sipas vlerës së tregut të lire, të individëve/familjeve, pasuritë e të cilëve preken nga shpronësimi për interes public, në funksion të procesit të rindërtimit, me qëllim realizimin e projekteve "Për zonat e reja në zhvillim, në Njësitë Administrative nr.4 dhe 8, zona "5 Maji".

Miratohet me shumicën e votave të këshilltarëve të pranishëm.

9. Projektvendim "Për disa ndryshime në vendimin nr.2, datë 30.03.2009, të Këshillit Bashkiak, "Mbi miratimin e Rregullores, për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksit në qytetin e Tiranës, i ndryshuar".

Miratohet me shumicën e votave të këshilltarëve të pranishëm.

10. "Për disa ndryshime në vendimin nr.101, datë 19.10.2022, të Këshillit Bashkiak "Për kompensimin e biletës së pajtimit mujor të përgjithshëm (abonesë së studentit), për studentët e pajisur me kartë student për të gjitha linjat, në transportin qytetës në Bashkinë e Tiranës".

Miratohet me shumicën e votave të këshilltarëve të pranishëm.

11. Projektvendim "Për disa ndryshime në vendimin nr.142, datë 23.12.2022, të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe Qendrës Shqiptare të Trashëgimisë për themelimin e përbashkët të organizatës jofitimprurëse qendres "Trashëgimia për të gjithë – Garda" dhe aktiviteteve të themelimit të kësaj organizate jofitimprurëse".

Miratohet me shumicën e votave të këshilltarëve të pranishëm.

12. Projektvendim "Për miratimin e projektit "Sipërmarrja ime për shkollën", hartuar sipas udhëzuesit operacional për zbatimin e tij".

Miratohet me shumicën e votave të këshilltarëve të pranishëm.

13. Projektvendim "Për disa ndryshime në vendimin nr. 126, datë 23.12.2022, të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2023, të ndryshuar".

Miratohet me shumicën e votave të këshilltarëve të pranishëm.




14. Projektvendim "Për dhënien e ndihmës financiare, nga Bashkia e Tiranës për Komunën e Preshevës dhe Bashkinë Kharkiv".



Miratohet me shumicën e votave të këshilltarëve të pranishëm.

15. Projektvendim "Për prishjen e detyruar të ndërtesës private, pallati nr.45, rruga "Luzi", Njësia Administrative Kasha, si rezultat i dëmtimit nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019".

Miratohet me shumicën e votave të këshilltarëve të pranishëm.

Mbledhja mbyllet.

Bruxhilda Kito 
Gjenerale Hysa 
HAKUW OSPAII 

B. Ferri 
F. D. K. 
A. K. 